



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGISË
BORDI

VENDIM

Nr.222, Datë 09.11.2021

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË BLERJES SË ENERGISË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA BURIMET E VOGLA TË RINOVUESHME NGA DIELLI, ERA DHE NGA PJESA E BIODEGRADUESHME E MBETJEVE TË NGURTA QË SHFRYTËZOJNË MBETURINAT INDUSTRIALE, URBANE DHE RURALE PËR VITIN 2021

Në mbështetje të nenit 10, pika 3 të ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 17.1.2018 “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale”; dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.96, datë 03.09.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 09.11.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 139/7 prot., datë 05.11.2021 nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2021”,

Konstatohet se:

- VKM nr. 369, datë 26.04.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”, në pikën 2 të tij, ngarkon ERE-n me detyrimin për miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, në përputhje me çmimin e mesatarizuar për vitin 2017, sipas parashikimeve të kësaj Metodologjie, bazuar në referencat e tabelës së paraqitur në këtë VKM përsa i takon LCOE dhe WACC ose të dhënave konkrete të kostove të investimeve që mund të sigurohen për vitet në vijim.
- VKM nr. 27, datë 17.1.2018 “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale” përcakton ndër të tjera se për investimet për të cilat subjektet janë pajisur me autorizimin përkatës pas datës 1 janar 2018 e në vijim, ERE do të miratojë çmimin në bazë

të të dhënave të grumbulluara, për sa i përket kostove reale të investimit, nëse rezultojnë të ndryshme nga parashikimet e kësaj metodologjie.

- Metodologjia e miratuar me VKM nr. 369, date 26.04.2017 përcakton kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në kthimin e arsyeshëm të vlerës së investimeve, sipas llojit të teknologjisë së përdorur. Në themel të metodologjisë së miratuar me VKM-në e mësipërme është llogaritja e kostos së prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme nëpërmjet formulës llogaritëse të LCOE-se (kosto e niveluar e energjisë elektrike).
- Ndërkohë, metodologjia e miratuar me VKM nr. 27, datë 17.01.2018 përcakton kriteret e llogaritjes së çmimit që duhet të paguhet për një njësi *output* si pagesë për fuqinë e prodhuar, me qëllim që të arrihet një rikthim financiar i caktuar – ose të vendoset thjesht çmimi që projekti duhet të fitojë për mwh, me qëllim që të arrihet *break-even* ose të ardhurat të barazojnë kostot e prodhimit.
- MIE me anë të shkresës me nr. 7789 prot., datë 29.10.2021, protokolluar me tonën me nr. 1042 prot., datë 02.11.2021, i drejtohet ERE-s për të vijuar procedurat për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit me përparësi.
- ERE me fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga këto burime do t'i drejtohet MIE-s për informacion lidhur me subjektet për të cilat Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka lëshuar (1) autorizimin paraprak, (2) miratimin përfundimtar për ndërtimin e veprave për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të vogla të rinovueshme nga dielli dhe era; si dhe gjeneratorët e vegjël me burim të rinovueshëm nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale.
- Ky informacion do të shërbejë për vlerësimin dhe shqyrtimin e të dhënave të nevojshme për llogaritjen e çmimeve për teknologjitë në fjalë, mbështetur në përcaktimet e legjislacionit në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2021.
2. Ngarkohet Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.